Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/510
Datë: 05.08.2022

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe, Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime ne Kosove, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 05.08.2022 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **Refuzohet** akreditimi i institucionit "OSKAR KAMMER SCHULE MBH-FOX-FT", me adresë: Rr. "Nazim Gafurri", nr. 124, në Komunën e Prishtinë, Republika e Kosovës, për kualifikimet:

   1.1. **ASISTENT I KUJDESIT SOCIAL SHËNDETËSOR,** Niveli III dhe IV sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 180 kredi të AAP.

   1.2. **BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL I INFERMIERISË,** Niveli III dhe IV sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 180 kredi të AAP.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucioni "OSKAR KAMMER SCHULE MBH-FOX-FT", për validim dhe akreditim të institucioni dhe rekomandimeve të dala nga Raportet e vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimeve, si dhe Raportet e ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të kualifikimeve/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Ekipi i ekspertëve vlerësues nga data 24.06.2022 kanë shqyrtuar dokumentacionin e institucionit "OSKAR KAMMER SCHULE MBH-FOX-FT", ndërsa me datë 27.06.2022 ka vizituar institucionin "OSKAR KAMMER SCHULE MBH-FOX-FT" lidhur me aplikimin për akreditim dhe validim për kualifikimet: 1.Asistent i Kujdesit Social Shëndetësor, dhe 2. Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë.

Ekipi i ekspertëve vlerësues ka përgatitur raportet për validim dhe akreditim për institucionin "OSKAR KAMMER SCHULE MBH-FOX-FT", për kualifikimet: 1.Asistent i Kujdesit Social Shëndetësor, dhe 2. Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë. Bazuar në raportet vlerësuese për validim të kualifikimeve dhe akreditim të institucionit e që nga raportet konstatohet se arsyetimi për refuzimin e akreditimit për kualifikimet e lartcekura i ekipit të ekspertëve vlerësues është i ngjashëm dhe përmban arsye të njëjta, rrjedhimisht nga kjo edhe arsyetimi i këtij vendimi për të dyja kualifikimet do jete i përbashkët, duke theksuar dallimet vetëm në ato raste kur ekipet e eksperteve vlerësues kanë dhënë vlerësime të ndryshme.

Ekipi i ekspertëve vlerësues në raportet e akreditimit për kualifikimet: Asistent i Kujdesit Social Shëndetësor dhe Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë, në pjesën 2 ku trajtohet **"Rezultatet e përgjithshme dhe përfundimet"**, ekspertët vlerësojnë se: "Gjatë vizitës ekipi i ekspertëve ka vërejtur se objekti ku operon shkolla nuk ofron kushte adekuate për mbarëvajtjen e procesit mësimor, me të gjeturat si vijon:

- Shkallët e brendshme të objektit janë të pa përshtatshme dhe vështirë të kalueshme për nxënësit, aq më tepër kur dihet mosha e tyre dhe vetëdija e tyre për kujdes ndaj vetës dhe ndaj të tjerëve.
- Hyrja në objekt (dera kryesore) ka qasje direkte në rrugën kryesore, një rruge e cila është shume e frekuentuar, e cila mund të paraqet rrezik potencial për nxënësit.
- Objekti nuk posedon sallë/hapësirë për realizimin e orës së edukatës fizike dhe sportit (duke qenë se lënda është planifikuar të mbahet).
- Objekti nuk posedon kabinet të TIK-ut (duke qenë se lënda është planifikuar të mbahet).
- Shkolla nuk posedon hapësirë rekreative si brenda objektit ashtu edhe jashtë, ku nxënësit mund të kalojnë pushimet mes orëve dhe zhvillimin e ndonjë aktiviteti tjetër shkollor.
- Shkolla nuk posedon parking për stafin, prindërit apo palët tjera të interesit.
- Objekti nuk posedon pjerrinën e as ashensorin për qasjen e nxënësve me aftësi të veçanta. Kapacitetet për procesin e arsimit dhe aftësimit profesional nuk janë të kënaqshme, pasi shumica e stafit të propozuar mësimdhënës në modulet profesionale nuk kanë kualifikimet relevante sipas Udhëzimit Administrativ 05/2015 (në modulet:

Etika në shëndetësi, Parandalimi i infeksionit, Nevojat bazë të njeriut dhe dietat, hyrje në kujdesin shëndetësor në komunitet, Kujdesi për të sëmurët në familje, dhe pastrimi dhe higjienizimi i mjedisit familjar), apo mungojnë stafi në dokumentet e dorëzuara (për modulet: mikrobiologji dhe imunologji, kujdesi për klientët në familje, kujdesi për të sëmurët në familje, pastrimi dhe higjienizimi i mjedisit familjar, kujdesi për klientët në familje, gatimi i dietave të balancuara sipas nevojës së klientëve, dhe TIK). Po ashtu, mungon stafi në disa lëndë të përgjithshme, si për edukatë fizike dhe matematikë, si dhe kualifikim joadekuat i mësimdhënësit të propozuar për lëndën e gjuhës angleze".

Ekipi i ekspertëve vlerësues në raportet e akreditimit për kualifikimet: Asistent i Kujdesit Social Shëndetësor dhe Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë, në pjesën ku trajtohet **"Komentet për cilësinë e të dhënave të paraqitura dhe dokumenteve përkatëse"**, ekspertët vlerësojnë se: "Si pjesë e kualifikimit përfshihet edhe realizimi i pjesës praktike/klinike një pjesë e së cilës realizohet në laboratorin brenda shkollës, ndërsa pjesa tjetër në institucione shëndetësore jashtë shkollës (aty ku shkolla ka marrëveshje bashkëpunimi). Megjithatë, shkolla ka të lidhur vetëm një marrëveshje bashkëpunimi me një klinikë, andaj është e pamjaftueshme për të realizuar planin e praktikës klinike jashtë shkollës. Marrëveshja me Oskar Kammer Schule në Gjermani e ofruar si dëshmi nga shkolla nuk është planifikuar në planin mësimor të arsimit, konkretisht nuk specifikon mbështetjen e mësimit praktik (mobilitetit) në Gjermani. Po ashtu, nuk ka alokim të mjeteve financiare (në planin e biznesit dhe atë financiar) për realizimin e praktikës klinike jashtë shkollës. Marrëveshja synon ndërmjetësimin në punësim dhe trajnim për kyçje në tregun e punës në Gjermani, e cila nuk i adreson planin e shkollës për realizimin e praktikës profesionale jashtë shkollës".

Ekipi i ekspertëve vlerësues në raportet e akreditimit për kualifikimet: Asistent i Kujdesit Social Shëndetësor dhe Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë, në pjesën ku trajtohet **"3. Stafi i nevojshëm për ofrim, vlerësim dhe certifikim"**, ekspertët vlerësojnë se: "Përveç një numri të planifikuar të mësimdhënësve, janë edhe disa mangësi si më poshtë:

- Në disa nga lëndët e përgjithshme mungojnë mësimdhënësit (për lëndët edukatë fizike dhe matematikë);
- Mësimdhënësi i propozuar për lëndën e gjuhës angleze ka kualifikim joadekuat për fushën;
- Mësimdhënësit në disa nga modulet profesionale nuk kanë kualifikime sipas UA 05/2015 për normativin për mësimdhënësit për arsimin profesional".

Ekipi i ekspertëve vlerësues në raportet e akreditimit për kualifikimet: Asistent i Kujdesit Social Shëndetësor dhe Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë, në pjesën ku trajtohet

"1. Struktura e nevojshme institucionale dhe qëndrueshmëria financiare", ekspertët vlerësojnë se: "Edhe pse shkolla Oskar Kammer Schule mbh-fox-ft ka të hartuara planin e biznesit dhe planin financiar dhe i ka dërguar si dëshmi, megjithatë në planin financiar janë paraqitur vetëm të hyrat nga pagesat e shkollimit, por jo edhe ndonjë burim tjetër financiar. Andaj, bazuar në këto dëshmi mund të konstatohet që shkolla nuk ka qëndrueshmëri financiare".

Ekipi i ekspertëve vlerësues në raportet e akreditimit për kualifikimet: Asistent i Kujdesit Social Shëndetësor dhe Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë, në pjesën ku trajtohet **"Komentet për cilësinë e të dhënave të paraqitura dhe dokumenteve përkatëse"**, ekspertët vlerësojnë se: "Marrëveshja me Oskar Kammer Schule në Gjermani e ofruar si dëshmi nga shkolla nuk është planifikuar në planin mësimor të arsimit, konkretisht nuk specifikon mbështetjen e mësimit praktik (mobilitetit) në Gjermani. Po ashtu, nuk ka alokim të mjeteve financiare (në planin e biznesit dhe atë financiar) për realizimin e praktikës klinike jashtë shkollës".

Këshilli Drejtues i AKK-së mbështetur në raportet e ekspertëve vlerësues lidhur me validimin dhe akreditimin e institucionit "OSKAR KAMMER SCHULE MBH-FOX-FT" lidhur me aplikimin për akreditim dhe validim për kualifikimet: 1.Asistent i Kujdesit Social Shëndetësor, dhe 2. Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit "OSKAR KAMMER SCHULE MBH-FOX-FT", dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar KD së AKK